

**UDHËZIM**  
**Nr. 7, datë 21.1.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 30.6.2023, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE DHE TË DIPLOMAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË ARDHUR NGA JASHTË VENDIT”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

**UDHËZOJ:**

**Neni 1**

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 30.6.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të njëvlershëmërisë së dëftesave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronjat “a” dhe “c” të pikës 2, të kreut II ndryshojnë si më poshtë:

*“a) Formulari i aplikimit për dëftesat e përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesa klase të arsimit parauniversitar plotësohen nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, drejtuar ZVAP.*

*c) Formulari i aplikimit për diplomën e arsimit të mesëm të lartë plotësohet online në portalin unik qeveritar e-Albania, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Parauniversitar (SMIP), drejtuar QSHA.”*

b) Nën-pika “iii” e shkronjës “b”, nën-pika “iv” e shkronjës “d”, të pikës 2 dhe pika 3, të kreut II shfuqizohen.

c) Në pikën 1, të kreut III togfjalëshi “...brenda 45 ditëve.” zëvendësohet me togfjalëshin “...brenda 30 ditëve.”

d) Pika 1.2, e kreut III shfuqizohet.

e) Pika 1.3, e kreut III ndryshon si më poshtë:

*“1.3 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, Komisioni i Njohjes së Dëftesave i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet.”*

f) Shkronja “c” e pikës 2, të kreut III ndryshon si më poshtë:

*“c) Depoziton në dosjen e aplikantit materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera shkresore ose të printuara.”*

g) Në pikën 1, të kreut IV togfjalëshi “...brenda 45 ditëve.” zëvendësohet me togfjalëshin “...brenda 30 ditëve.”

h) Pika 1.6, e kreut IV ndryshon si më poshtë:

*“1.6 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SNJD-ja i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet dhe paraqitet aplikim i ri.”*

i) Në pikën 1, të kreut VI togfjalëshi “...ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ka të drejtë të bëjë ankim në portalit unik qeveritar “e-Albania” kundër vendimit...”.

j) Pas pikës 3 të kreut IV shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

*“3/1. Aplikimet dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtoben dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe Komisioni i Njohjes së Dëftesave dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

**Orjana Osmani**